



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2024:073091  
Datë: 07.10.2024  
Numri i dokumentit: 06263716

C.nr.1377/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, me praktikanten D.O. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve H.V. me numër personal ..... I.K. me numër personal .... dhe F.L. me numër personal ..... nga Prizreni të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat B.M.K. nga Prishtina kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 239.09 euro, jashtë seance, me datë 07.10.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve H.V., I.K. dhe F.L. nga Prizreni DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:
  1. Paditësi H.V. për periudhën kohore 01.10.2022- 20.11.2022, ti paguhet në shumën prej 76.97 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (05.04.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
  2. Paditësit I.K. për periudhën kohore 01.10.2022- 20.11.2022, ti paguhet në shumën prej 81.06 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (05.04.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
  3. Paditësit F.L. për periudhën kohore 01.10.2022- 20.11.2022, ti paguhet në shumën prej 81.06 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (05.04.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Paditësit H.V., I.K. dhe F.L. në këtë gjykatë me datë 05.04.2024, përmes të autorizuarit të tyre B.M.K. nga Prishtina, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria për Arsim, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditësi H.V. punon në cilësinë e Sekretarit të Shkollës në institucionin arsimor SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren, Paditësi I.K. punon në cilësinë e Mësimdhënësit në institucionin arsimor SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren, Paditësja F.L. punon në cilësinë e Mësimdhënësit në institucionin arsimor SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren, të njëjtit nuk kanë pranuar mjetet e parapara për kompensimin e shpenzimeve inflacionit në pagë dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar, ashtu që paditësit H.V. në pagën bazë e ka në shumë prej 399.75 euro i takon e drejta kompensimin për inflacion, për periudhën kohore nga data 01.10.2022 e deri me datën 20.11.2022 i takon në lartësi prej 76.97 euro, paditësit I.K. në pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro i takon e drejta kompensimin për inflacion, për periudhën kohore nga data 01.10.2022 e deri me datën 20.11.2022 i takon në lartësi prej 81.06 euro, paditësja F.L. në pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro i takon e drejta kompensimin për inflacion, për periudhën kohore nga data 01.10.2022 e deri me datën 20.11.2022 i takon në lartësi prej 81.06 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 12.08.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësve është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi me nr. protokolli 519/102 të datës 13.12.2023 paditësi H.V. është në marrëdhënie pune tek Shkolla e Mesme e Ulët “Motrat Qiriazi” në Prizren, në pozitën e sekretarit të shkollës, që nga viti 1985 dhe vazhdon të jetë. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është koeficienti prej 6.3 euro shuma 399.75 euro.

Nga vërtetimi me nr. protokolli 519/40 të datës 13.12.2023 për paditësin I.K. e lëshuar nga e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënës tek Shkolla e Mesme e Ulët “Motrat Qiriazi” në Prizren, që nga viti 2015 dhe vazhdon të jetë. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 421.00 euro.

Nga vërtetimi me nr. protokolli 519/35 të datës 13.12.2023 për paditësin F.L. e lëshuar nga e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënës tek Shkolla e Mesme e Ulët “Motrat Qiriazi” në Prizren, që nga viti 2009 dhe vazhdon të jetë. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 421.00 euro.

Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për paditësin H.V.
- Për periudhën 01.10.2022-20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 399.75 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 76.97 euro ( $399.75 * 11.6\% = 46.37 * 1 = 46.37$ ) si dhe periudha 20 ditë muajit Nëntor

është 33.2 euro sipas llogaritjes ( $46.37/30=1.66*20$  ditë=33.2 euro), në llogaritje prej 79.57 euro. Mirëpo në kërkesën e paditësit është kërkuar në shumë prej 76.97 euro në këtë drejtim gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, “vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, andaj duke pasur parasysh kërkesën e paditësit iu aprovua shuma prej 76.97 euro.

- Për paditësin I.K.
- Për periudhën 01.10.2022-20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 81.06 euro ( $421*11.6%=48.83*1=48.83$ ) si dhe periudha 20 ditë të muajit Nëntor është 18.06euro sipas llogaritjes ( $48.83/30 =1.66*20$  ditë = 33.2 euro), në shumë prej 81.06 euro.
- Për paditësin F.L.
- Për periudhën 01.10.2022-20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 81.06 euro ( $421*11.6%=48.83*1=48.83$ ) si dhe periudha 20 ditë të muajit Nëntor është 18.06euro sipas llogaritjes ( $48.83/30 =1.66*20$  ditë = 33.2 euro), në shumë prej 81.06 euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (05.04.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2024:073091  
Datë: 07.10.2024  
Numri i dokumentit: 06263716

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.1377/2024, datë 07.10.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.